

Tiranë, më 10/02/2025

STATUT DHE AKT THEMELIMI I SHOQËRISË

I Shoqërisë tregtare *Jobmaster Shpk*

Mbështetur në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr 9981 datë 14.04.2008 " Për Shoqëritë Tregëtare", Ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2008 " Për Qendrën Kombëtare e Biznesit" të ndryshuar, dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë tregtare, me vullnetin tonë të lirë, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi dhe statuti të shoqërisë

Ortaket, Klodjan Bardhoci, me numër personal J01119051O, dtl.19.11.1990, lindur në Kukës, banues në Tiranë, Rruga "Agron Jano" Godina Nr.7, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar.

Dhe

Rigers Kuçi, i biri Ramiz, lindur me 07.03.1991, në Tirane, Shqiperi, dhe banues në Tirane , i pajisur me nr. ID: J10307078G, shtetas shqiptar, madhor, me zotësi juridike dhe për të vepruar

KREU I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

NENI 1: Data e themelimit, Emri dhe Themeluesit.

Sot me datë 10/02/2025 unë, themeluesi Klodjan Bardhoci, i biri i Muharrem, lindur me 19.11.1990, në Kukës, dhe banues në Tirane , i pajisur me nr. ID J01119051O,.

Dhe

themeluesi Rigers Kuçi, i biri Ramiz, lindur me 07.03.1991, në Tirane, Shqiperi, dhe banues në Tirane , i pajisur me nr. ID: J10307078G,

kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin Jobmaster Shpk

Selia e shoqërisë

NENI 2:

Selia e shoqërisë tregtare private *Jobmaster Shpk*. do të jetë në adresën: **Rruga "Abdyl Frashëri"**
Godina 11, hyrja 1, Njësia administrative nr.5, Tiranë

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, mund të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filial si Brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë dhe ortakëve.

Objekti I veprimtarisë

NENI 3:

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushat:

Aktivitet në fushën e konsulencës dhe të menaxhimit të burimeve njerëzore. Menaxhim strategjik në fushën e burimeve njerëzore. Shërbime të këshillimit dhe rekrutimit në këtë fushë. Politikë të burimeve njerëzore. Zhvillimi i procedurave të burimeve njerëzore. Trajnimi dhe zhvillimi. Proçes i plotë rekrutimi punonjësish. Shoqëria do të japë konsulencë biznesi në fushën e investimeve financiare, ndërmjetësim ligjor për kompani dhe individë që ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj. Ndërmjetësim të përgjithshëm për kompani dhe individë brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë. Konsulencia për strukturim ose ristrukturim, planifikim dhe zhvillim të mënyrës së organizimit të kompanive. Shërbim përfaqësimi ndaj shoqërive tregtare, individëve dhe tregtareve, qofshin këta vendas apo të huaj. Konsulencë për investime dhe zhvillim në fushën e Hoteleri Turizëm. Aktivitet agjencie dhe agjenti. Rekrutim. Vlerësim dhe përpilimin e kontratave të kompanive para apo gjatë lidhjes së marrëveshjeve. Shërbimin e ndërmjetësimi në punësim. Informim për vendet e lira të punës. Ndërmjetësim për punësim. Këshillim dhe orientim për punë dhe profesion. Informacion dhe këshillim. Udhëzime për punësim, vlerësim të nevojave, zhvillim të karrierës apo të profesionit metodika për punësim. Pjesëmarrje në përmirësimin e tregut të punës nëpërmjet trajnimit dhe ndërhyrjeve në përmirësimin e legjislacionit të tregut të punës. Shërbime ndërmjetësimi në të dy kahët për punëdhënësin por edhe për punëmarrësin, apo shërbime ndërmjetësimi të pa lidhura ngushtësisht me çështjet e vetëm punësimit, etj. Shërbime për punëdhënësit, kryesisht informacion mbi tregun e punës, shërbime të ofrimit të kandidatëve të mundshëm për rekrutim në punë, informacion për programet e ndryshme të tregut të punës etj. Shërbimet e migracionit në fushën e imigrimit edhe atë të emigrimit. Procedura ligjore për pajisjen me leje pune, viza, leje qëndrimi për shtetasit e huaj në Republikën e Shqipërisë. Referuar vetë subjekteve të mirëpërcaktuara në këtë ligj janë identifikuar të gjithë shtetasit e huaj që synojnë të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe kanë si qëllim tranzitimin, punësimin, studimin apo ripranimin. Këta të huaj trajtohen në përputhje me të drejtat dhe liritë themelore si dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Kohëzgjatja e Shoqërisë

NENI 4:

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pakufizuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

Kapitali I Shoqërisë

NENI 5:

5.1 Kapitali themeltar fillestar I shoqërisë është 100,000 (njëqindmijë) lekë, i cili përbëhet nga 2 (dy) kuota me vlerë nominale prej 100,000 (njëqindmijë) lekë . Kapitali është nënshkruar si më poshtë

5.2 Ortaku themelues Klodjan Bardhoci, zotëron 1 kuota me vlerë të përgjithshme 50,000 (pesdhjetmije) lekë, që përbën 50% të kapitalit themeltar.

Dhe

5.3 Ortaku themelues Rigers Kuçi, zotëron 1 kuota me vlerë të përgjithshme 50,000 (pesdhjetmije) lekë, që përbën 50% të kapitalit themeltar.

5.4 Kapitali themeltar do të depozitohet në një Bankë në Shqipëri me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër ose në arkën e shoqërisë.

5.5 Çdo kuotë jep të drejtën e një vote për të marrë vendime sipas ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”. Të gjitha votat do të ushtrohen nga ortakët sipas zotërimeve.

5.6 Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet ose të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar)

Drejtimi I Shoqërisë

NENI 6:

Organi Vendimmarrës (Asambleja e Përgjithshme). Kompetencat.

11.1 Asambleja e Përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë.
- b) ndryshimin e statutit
- c) emërimin e shkarkimin e administratorit
- ç) emërimin e shkarkimin e likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar.
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike.
- dh) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratoret, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit.
- f) pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera administrative
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statut.

NENI 7:

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë Përgjithshme.

12.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e tu dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Njoftimi bëhet nga administrator i shoqërisë.

12.2 Asambleja e përgjithshme duhet të thirret të paktën një herë në vit për të vendosur për çështje të tilla si miratimi i bilancit dhe pasqyrave financiare, miratimi i raportit të auditimit të shoqërisë.

12.3 Mbledhjet mbahen në selinë e shoqërisë apo edhe në një vend tjetër të njohur nga ortaku i vetëm.

NENI 8:

Administratori i shoqërisë.

Shoqëria do të drejtohet nga administrator i saj dhe përfaqësuesi ligjor i saj. Ai është përfaqësuesi i Shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj.

Asambleja e përgjithshme emëron administratorin e shoqërisë. Afati i emërimit është 5 (pesë) vjet me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorit krijon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Administratori i parë i shoqërisë deri në emërimin e tij nga mbledhja e parë e Asamblesë së përgjithshme është Xheni Goxhaj, lindur me 04.06.1991, e pajisur me nr. personal J15604093H.

Çdo kontratë do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posaçme. Administratori ushtron kompetencat e mëposhtme:

Kryen të gjitha veprimet e administrimit të shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme.

- b) Vepron me të tretët në emër dhe për llogari të shoqërisë Brenda kompetencave të parashikuara në statut apo dhe në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
- c) Kryen emërimin dhe shkarkimin nga puna të punëmarrësve të shoqërisë.
- d) Jep urdhëra dhe udhëzime punëmarrësve dhe vendos sanksione ndaj tyre, në përputhje me kontratat e punës dhe rregulloret e brendshme të shoqërisë.
- e) Drejton dhe organizon punën në mënyrë të tillë që të sigurojë suksesin e shoqërisë në veprimtarinë e saj ekonomiko-financiare.
- f) Të raportojë para asamblesë së përgjithshme sa herë që asambleja e kërkon si dhe në rastet kur është i nevojshëm raportimi në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë.
- g) Të zbatojë vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme.
- h) Ti paraqesë në mënyrë të rregullt dhe në kohë të përshtatshme Asamblesë Përgjithshme, raportin e administrimit, inventarit, bilancin dhe llogaritë vjetore si dhe përgjigjet për to.
- i) Të ushtrojë të drejtat dhe detyrime të parashikuara nga ligji Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare".
- j) Administratori është përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjit dhe statutit dhe për faje të kryera gjatë administrimit sipas parashikimit të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe ligjeve të tjera në fuqi.

Statuti i Administratorit përfundon:

- a) me mbarimin e afatit.
- b) me shkarkimin e tij nga Asambleja e Përgjithshme.
- c) kur vetë Administratori jep dorëheqjen vullnetarisht ose me.

NENI 7:

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve të shoqërisë.

NENI 9 :

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

NENI 10 :

Shoqëria do të ketë vulën e saj me madhësi të zakonshme, me logon dhe tekstin brenda saj.

NENI 11 :

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi dhe veçanërisht të ligjit Nr 9901 datë 14.04.2008 " Për Krijimin e Shoqërive Tregtare", si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombëtare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri.

Çështjet që nuk trajtohen në këtë Statutin -Akt themelimi, rregullohen në rregulloren e shoqërisë si dhe në legjislacionin përkatës Shqiptar.


NENI 12 :

Akt i themelimit u përpilua në 5 kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë **Jobmaster Shpk**.

Statuti- Akti i themelimit u nënshkrua nga ortaku i vetëm i shoqërisë.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE TREGTARE Jobmaster Shpk.

Klodjan Bardhoci

Klodjan Bardhoci


Rigels Kuçi

Rigels Kuçi
